

Thirrje për shprehje interesi për “Akademinë politike”

A jeni person i ri, aktiv, i moshës 18 deri 29 vjeçe, me përkushtim të fuqishëm në ndërtimin e demokracisë kuptimplote dhe pjesëmarrëse në Kosovë? A jeni të gatshëm të investoni kohë dhe mund për zhvillimin dhe zbatimin e një nisme me njerëz të tjerë që mendojnë si ju? A jeni të interesuar të merrni mbështetje dhe t’i zhvilloni aftësitë tuaja të të menduarit kritik, avokimit, ndërtimit të ekipit, të shkruarit dhe negocimit për zgjidhjen e sfidave të komunitetit tuaj? Atëherë, **Akademia politike** është ajo që ju duhet!

Akademia politike organizohet nga Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), në bashkëpunim me Zyrën e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR). Synimi ynë është të sigurojmë që gratë dhe burrat e rinj, të cilët shpeshherë marginalizohen nga proceset politike, pajisen me njohuri dhe aftësi të nevojshme për të siguruar pjesëmarrje efektive dhe për ta udhëhequr konsolidimin dhe forcimin e komuniteteve të tyre.

Kurrikula e Akademisë politike ofron:

- ✓ Përmirësim të hartimit të politikave, hartimit të fjalimeve dhe aftësive të prezantimit;
- ✓ Përmirësim të njohurive për barazinë gjinore dhe shkathtësive për integrimin e çështjes gjinore;
- ✓ Aftësi për të menduar në mënyrë kritike dhe për të sfiduar informacionin subjektiv;
- ✓ Zhvillim të edukimit mediatik;
- ✓ Zotërim të komunikimit dhe avokimit;
- ✓ Rrjetëzim me udhëheqës të tjerë të rinj dhe diskutimi mbi përpjekjet dhe sfidat në komunitete;
- ✓ Certifikim.

Seminari do të mbahet nga **20 deri 23 qershor 2019**. Për të aplikuar, ju lutemi dërgoni rezymenë tuaj dhe një letër të shkurtër motivimi, në gjuhën angleze, shqipe ose serbe, deri më **7 qershor 2019** përmes postës elektronike në adresën: aibek.zhumashukurov@osce.org.

Ju lusim ta keni parasysh që vetëm kandidatet e përzgjedhur në listë të ngushtë do të kontaktohen për intervistë.